

HAXHI 2011

Njoftojmë të interesuarit se Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës edhe këtë vit bën organizimin e Haxhit. Udhëtimet deri në vendet e shenjta janë paraparë **VETËM ME AEROPLAN. Çmimi i udhëtimit me aeroplan kushton 2950 € (dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro.)**

Në çmim janë të përfshira:

- Të gjitha shpenzimet e nevojshme për Haxhiun, **E EDHE USHQIMI.**
- Jelekët me mbishkrim të Kosovës dhe Ihramat.
- Kurbani.

Me rastin e regjistrimit, përveç pagesës, duhet te sillen edhe dokumentet në vijim:

- Pasaportat duhet të jenë të Republikës së Kosovës me së paku gjashtë muaj afat prej kohës së udhëtimit, respektivisht deri më **20.04.2012.**
- 2 fotografi të formatit për pasaportë dhe prapaskenën – hijen duhet ta kenë të bardhë.
- Gratë nën moshën 55 vjeçare duhet të kenë ndonjë të afërt me vete (burrin, vëllanë, babanë, djalin), dhe me rastin e aplikimit patjetër duhet të kenë me vete edhe certifikatën e atij të afërmi që shpjegon lidhjen e tij me gruan, të përkthyer në arabisht dhe të vërtetuar nga përkthyesi i gjyqit.

Shënim: Luten të interesuarit që sa më parë të paraqiten në Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri për aplikim ngase këtë vit lista është e kufizuar dhe pritet që mbyllja e saj të bëhet më herët se zakonisht. Respektivisht, me **15 SHTATOR 2011** mbyllet lista e Haxhit. Ata që nuk marrin vaksinën me kohë, nuk do të mund të marrin vizë.

P.S. Për datat përkatëse (të vaksinimit, nisjes, kthimit) do të informoheni me kohë.